

RAPORT MBI VIZITËN NË TERREN TË ZHVILLUAR NË KUADËR TË KËRKESËS PËR PEZULLIMIN E PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E HEC-IT SEKË DHE ZAIS, NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË LUMIT TË URAKËS DHE ZALLIT TË MELTHIT

1 – TË PËRGJITHSHME

Kryesia e Fshatit Gjocaj dhe Qendra Kërkimore për Gjeoshkencë e Mjedis, nëpërmjet një sërë shkresash drejtuar disa prej institucioneve me të rëndësishme në vend, shoqëruar këto edhe me disa protesta të mbajtura prej tyre (disa madje edhe të dhunshme) si pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ashtu edhe në vendin ku po punohet për ndërtimin e HEC-it Sekë dhe Zais, kanë kërkuar pezullimin e punimeve që po zhvillohen në zbatim të kontratës publike me objekt "Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në Pellgun Ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare "Seka Hydropower sh.p.k", me pretendimin se ky HEC shkakton një dëm të rëndë e të pakthyesëm, i cili cënon rëndë interesin publik dhe atë privat të 9200 banorëve të kësaj zone.

Sipas banorëve të zonës, ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais cënon në mënyrë serioze mundësinë për të jetuar në atë zonë, si dhe shkakton dëme të rënda në tokat e tyre, në blegtori e bujqësi, të cilat janë thujtë të vetmet mjete për të jetuar, si dhe shkatërron bimësinë e zonës, faunën e egër, burimet nëntokësore, zonën e mbrojtur me ligj, etj. Më konkretisht, banorët e zonës ankohen se:

- **Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, dëmton burime me ujëra të pijshëm për shërbim komunar të njerëzve pranë, por që shërbejnë edhe si ujëra kurativ dhe balnear për të gjithë Bashkinë e Matit dhe më gjërë.** Raportet studimore lidhur me teknikat dhe mekanizmat e funksionimit të këtij HEC-i, parashikojnë funksionimin e tij përgjat kaskadës së lumit Flim në zonën e Zall Gjocaj, duke marrë të gjithë ujin e lumit dhe duke e çuar atë nëpërmjet tubave dhe një tuneli në Zais të Mirditës ku do të prodhohet një sasi e caktuar energjie. Pastaj, me anë të një tuneli, uji i dalë nga HEC-i Zais sëbashku me prurjet lumore të lumit Urakë çohen në një tjetër tunel dhe nga aty me një sërë tubash çohen në HEC-in Sekë për të prodhuar përsëri energji.
- **Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais prek zonën e mbrojtur të kategorisë së dytë siç është Parku Kombëtar Lurë –Zall Gjocaj, si dhe zonën e mbrojtur të kategorisë së tretë me shkall të parë mbrojtjeje siç janë Kanionet e Flimit dhe të Urakës.**
- **Dëmton kanione, lugina dhe gryka natyrore, të cilat sigurojnë prurje të caktuara ekonomike dhe zhvillime të reja për ekonominë lokale.**

- **Mos informimi i banorëve të zonës që preken direkt nga ndërtimi i këtij HEC-i, si dhe mos përfshirja e tyre në vendimmarrje,** sikurse parashikohet nga Konventa e Aarhusit apo legjisllacioni në fuqi.
- **Mos kryerja e një studimi nga kompania zbatuese e projektit** që të vërtetojë se fauna dhe iktiofauna e lumit Flim me rreth 5000 litra/sek mund të jetojë në kushte jashtë ekstremit të tolerancës, me sasi ujore më pak se 2 – 3%, e përcaktuar si prurje ekologjike që matet me 50 – 100 litra/sek, si dhe mos kryerja e një sërë studimesh të tjera të parashikuara në ligjin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Duke marrë shkas nga pretendimet e mësipërme dhe shkresat e bëra nga grupe të ndryshme të komuniteteve që preken nga ndërtimi i këtij HEC-i, si dhe me qëllim verifikimin në terren të pretendimeve të ngritura nga banorët e zonës, **është miratuar Urdhëri i Përbashkët i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit për "Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Verifikimin e Problematikave të Ngritura nga Banorët e Zonës për Ndërtimin e HEC-it Sekë dhe Zais".**

2 –VIZITA NË TERREN

Në zbatim të Urdhërit të Përbashkët, **në datën 22.10.2019**, Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) i kryesuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe në përbërje të të cilit ishin edhe përfaqësues të MIE, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Lezhë dhe asaj Dibër që kanë nën administrim zonën ku do të ndërtohet ky HEC, si dhe një përfaqësues i Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore për Basenin Ishëm – Erzen – Mat, **ka zhvilluar një vizitë në terren në fshatin Lami i Madh, Gjoçaj dhe Zall – Gjoçaj (Melth) me qëllim verifikimin e të gjitha pretendimeve të ngritura nga banorët e zonës.**

Vepra e marrjes (VM) së HEC-it Zais do të ndërtohet në Zall – Gjoçaj (Melth), kurse vepra e marrjes së HEC-it Sekë është projektuar të ndërtohet poshtë godinës së HEC-it Zais.

Për verifikimin në terren u krye monitorim dhe kontroll përgjat pjesës së sipërme të Lumit Melth, në fshatin Gjoçaj, si dhe segmente të lumit të Urakës poshtë fshatit Zajs.

Nga verifikimet në terren rezulton se subjekti është në fazën e punimeve të cilat konsistojnë në ndërtim të rrugëve të reja dhe rehabilitim të rrugëve ekzistuese, punime dhe mbrojtje me gurë të çimentuar, hapje tunelesh, etj.



Foto 1. Pamje nga punimet në tunel



Foto 2. Pikë e projektuar si VM

Përsa i përket HEC-it Zajs, me VM në Lumin Melth, fshati Zall-Gjoçaj dhe Godinë Centrali në Lumin e Urakës, nga ana e subjektit po kryhen punime përgatitore duke avancuar me rrugë drejt veprës së marrjes në kuotën 975 m. Aktualisht, mbeten për tu hapur edhe rreth 2.5 km rrugë.

Nga kqyrja në terren, vërehet se subjekti nuk ka ndërtuar akoma VM-në dhe kanale devijimi të ujit. Burimi ujqor në pikën e VM-së ka prurje normale për sezonin.

Duke lëvizur sipas rrjedhës së lumit rreth 500 m nga pika e projektuar si VM, vërehet një kanal vaditje, i cili devijon një sasi të konsiderueshme uji që përdoret nga rreth 2-3 shtëpi të banuara në këtë zonë. Duke lëvizur në drejtim të rrjedhës së lumit vërehet humbje e prurjeve të ujit të lumit në shtresat zhavorrore.



Foto 3. Kanal Ujitje



Foto 4. Pamje e shtratit të lumit ku uji ka drenuar poshtë shtresave të zhavorrit

E njëjta situatë vërehet edhe në segmente të tjera të projektit, që vazhdon me ndërtimin e infrastrukturës për shtrirjen e tubacioneve dhe ndërtimin e veprave të marrjes dhe godinave të centralit të HEC-eve.



Foto 5. Pamje e Luginës Lumi Melth



Foto 6. Pamje e Luginës Përroi Urakë

Përsa i përket aspektit topografik nga matjet e kryera në terren rezulton se:

Për HEC-in Zais, kanë filluar punimet e tunelit nga të dy portalet, si dhe për sheshin e godinës.

Portali i Hyrjes Y = 4425469.020 X = 4622895.874 Z = 958.174

Portali i Daljes Y = 4424313.627 X = 4624117.163 Z = 956.833

Sheshi për Godinën Y = 4423898.710 X = 4624344.971 Z = 708.338

Gjithashtu, punohet edhe në hapjen e trasesë ndërmjet portalit të hyrjes dhe veprës së marrjes në koordinatat:

Traseja për tek VM Y = 4426248.140 X = 4623003.227 Z = 852.949 (deri këtu kishin avancuar punimet e hapjes së trasesë në drejtim të vendit ku do të ndërtohet VM e HEC – it Zais).

Për HEC-in Sekë, kanë filluar punimet e tunelit nga të dy portalet, VM-në, bazamentin e godinës, si dhe tubin e presionit.

Vepra e Marrjes Y = 4423092.729 X = 4623632.024 Z = 691.898

Portali i Hyrjes Y = 4422963.716 X = 4623475.235 Z = 689.844

Portali i Daljes Y = 4421290.128 X = 4623181.836 Z = 685.218

Bazamenti i Godinës Y = 4420263.217 X = 4619731.048 Z = 358.145

Shënim: Të gjitha matjet shoqërohen me një gabim rreth $\pm 3m$ pasi matjet janë të pa procesuara me sistemin AlbPos, pasi antenat e këtij sistemi nuk janë në gjendje pune në rajonin e Veriut.

Për sa i përket aspektit hidrogeologjik, nga verifikimi në terren për zonën ku do të ndërtohet HEC-i Zais, u morrë informacion për:

- Gjëndjen aktuale të furnizimit me ujë të banorëve të fshatrave të zonës në studim;
- Evidentimin e burimeve ujore në zonë.

Për sa i përket gjëndjes aktuale të furnizimit me ujë të banorëve të fshatrave të zonës në studim, bazuar mbi bisedat e zhvilluara me disa banorë të zonës gjatë kësaj vizite, fshati Gjoçaj ka rreth 40 familje nga të cilat aktualisht jetojnë vetëm 4 familje. Banorët e këtij fshati furnizohen me ujë në mënyrë individuale. Ndërsa banorët e fshatit Lami i Madh furnizohen me ujë nga burimi “Kroi i Kolës”.

Për sa i përket evidentimit të burimeve ujore në zonë, gjatë kësaj vizite në këtë zonë u evidentuan gjithsej 3 (tre) burime ujore. Konkretisht:

Gjatë rrugës u evidentua një burim në fshatin Lufaj – Mirditë. Burim i cili del nga formacionet ultrabazike $\sigma J_2(Hs)$ me prurje rreth $Q = 0.1$ l/s (i vlerësuar me sy të lirë) dhe me koordinata: $X = 4622052$
 $Y = 4420040$

Vlerësuar nga kushtet gjeologo – hidrogjeologjike të daljes së tij, ky burim nuk ndikohet nga ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, pasi ky burim del në akuiferin me poro – çarje (formacionet ultrabazike), kurse HEC – et janë kryesisht në akuiferë me porozitet çarje – karst (formacione gëlqerore).

Burimi “Kroi i Kolës” në fshatin Melth, mbështetur edhe nga verifikimi në terren, del nga shkëmbinjtë karbonatik të Kretakut (Cr), me prurje rreth $Q = 0.3$ l/s (i vlerësuar me sy të lirë). Ky burim, i cili përdoret nga banorët e fshatit Lami i Madh dhe kalimtarët e rastit, është i vetmi burim për furnizimin me ujë të tyre. Nga informacioni i marrë në terren, burimi është dëmtuar gjatë hapjes së rrugës për tek VM-ja e HEC-it Zais, por shoqëria koncesionare është duke punuar për rregullimin dhe kaptazhimin e tij, pasqyruar kjo edhe në fotot e mëposhtme. Burimi ka këto koordinata: $X = 4622656$
 $Y = 4425202$



Foto 1. Burimi “Kroi i Kolës” në fshatin Melth

Bazuar mbi të dhënat që SHGJSH disponon për zonën e studimit, ky burim është evidentuar edhe më parë nga hidrogjeologjia dhe është vlerësuar me prurje $Q = 1.2$ l/s (i matur në vitin 1968), si dhe gjëndet në materialin faktik të Hartës Hidrogjeologjike 1 : 200 000.

Burimi “Kroi i Kolës” duke qenë një burim që del nga formacionet karstike, është një burim i ndjeshëm karshi ndërhyrjeve të ndryshme në zonën e ushqimit të tij. Burimi ndodhet poshtë tunelit që po ndërtohet për HEC-in Zais, kështu që hapja e tunelit mund të ndikojë në regjimin hidrodinamik të tij. Koordinatat në hyrje të tunelit për HEC-in Zais janë: $X = 4622900$
 $Y = 4425468$

Lumi Zalli i Melthit - VM e HEC-it Zais do të ndërtohet tek Ura e Lalës në Zall – Gjoçaj – në lumin Zalli i Melthit. Kjo vepër do të ndërtohet në kontakt të formacioneve ultrabazike me ato gëlqerore. Koordinatat e VM-së së HEC-it Zais që do të ndërtohet janë: $X = 4623224$
 $Y = 4428458$

Për sa i përket aspektit gjeologo – inxhinierik lidhur me punimet për hapjen e rrugëve në funksion të këtij HEC-i, nga verifikimi në terren rezultoi se punimet e kryera për hapjen e traseve të rrugëve nuk kanë shkaktuar fenomene të rrezikshme gjeologo – inxhinierike si destabilizim shpatesh me aktivizim të rrëshqitjeve të mundshme apo edhe rrëzim e shembje gurësh. Në ato segmente rrugore ku shpati është shumë i pjerrët u vu re se janë ndërtuar mure mbajtëse për eliminimin e aktivizimit të fenomeneve gjeodinamike të rrezikshme në ato sektorë ku janë ndërtuar.

Gjithashtu, gjatë kësaj vizite u konstatua se edhe menaxhimi i mbetjeve inerte të gjeneruara si rezultat i punës për hapjen e traseve të rrugëve apo tunelit, ishte në përputhje me ruajtjen e ekuilibrit natyror të shpatit dhe shpateve në tërësi.

3 –VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT

KONTRATA E KONCESIONIT, LEJET, KARAKTERISTIKAT E OBJEKTIT, AFATET

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (sot MIE) ka lidhur me Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Hydro Project” sh.p.k, dhe “Gener 2” sh.p.k (Koncesionari) kontratën e koncesionit të formës “BOT” me Nr. 7030 Rep., Nr. 2134 Kol., datë 12.06.2013, ndryshuar me kontratën shtesë Nr. 2247 Rep., Nr. 1095 Kol., të datës 18.08.2017 për ndërtimin e hidrocentraleve “Sekë” dhe “Zais”, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë”, me fuqi të instaluar 14 962 kW dhe prodhim energjie 63 760 000 kWh/vit.

Kontrata e koncesionit të formës “BOT” me Nr. 7030 Rep., Nr. 2134 Kol., datë 12.06.2013 ka parashikuar ndërtimin e HEC-it “Sekë”, me vendndodhje në lumin e Urakës, rrethi Mat, me fuqi të instaluar 11 200 kW dhe prodhim energjie 54 622 647 kWh/vit, me karakteristika si më poshtë vijon:

- Kuota e VM-së 698 m
- Kuota e VM-së 702 m
- Kuota e Godinës së Centralit në Lumin Urakë 355 m

- Fuqia e Instaluar 11 200 kW
- Prodhimi Vjetor i Energjisë Elektrike 54 622 647 kWh

Shoqëria Koncesionare, me anë të një shkrese drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritetit Kontraktues) ka kërkuar ndryshimin e projektit të zbatimit për hidrocentralin “Sekë”. Në këtë kuadër, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues), me shkresën nr. 257/2 prot., datë 13.03.2014, ka dërguar pranë AKBN-së projektin e zbatimit për Oponencë Teknike nga kjo e fundit.

AKBN, me shkresën nr. 2489 prot, datë 09.03.2016 ka përcjell pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Oponencën Teknike me karkarakteristikat teknike si më poshtë:

Hidrocentrali Zais

- Kuota e VM-së në Degën e Lumit Zalli i Melthit 975 m m.n.d
- Kuota e Godinës së Centralit (afër Lumit të Urakës) 715 m m.n.d
- Fuqia e Instaluar 2 295 kW
- Energjia Mesatare Vjetore 8 060 000 kWh

Hidrocentrali Sekë

- Kuota e VM-së në Lumin e Urakës 698 m m.n.d
- Kuota e Godinës së Centralit 355 m m.n.d
- Fuqia e Instaluar 12 667 kW
- Energjia Mesatare Vjetore 55 700 000 kWh

Fuqia Total

14 962 kW

Prodhimi

63 760 000 kWh/vit

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues), me shkresën nr. 1881/3 prot, datë 26.04.2017, ka miratuar Projektin e Zbatimit.

Ndryshimet e parametrave të HEC-it janë pasqyruar në kontratën shtesë të koncesionit nr. 2247 Rep., Nr. 1095 Kol., të datës 18.08.2017 për ndërtimin e hidrocentraleve “Sekë” dhe “Zais”, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë”, me fuqi të instaluar 14 962 kW dhe prodhim energjie 63 760 000 kWh/vit, ku referuar optimizimit të skemës së shfrytëzimit hidroenergjetik të veprës, hidrocentrali “Sekë”, i parashikuar në kontratën koncesionare të formës “BOT” me Nr. 7030 Rep., Nr. 2134 Kol., datë 12.06.2013 do te quhet “Sekë” dhe “Zais”.

Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), nëpërmjet shkresës nr. 2637/2 prot., datë 28.12.2018 “Dërgohet Vendimi nr. 16, datë 03.10.2018 “Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun Ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë”,

drejtuar Arkivitet të Këshillit të Ministrave, Arkivitet Qëndror Teknik të Ndërtimit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe dhe shoqërisë Koncesionare ka dërguar bashkëlidhur:

- a) Vendimin nr. 16, datë 03.10.2018 “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për Objektivin: “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun Ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë”;
- b) Hartën e Planvendosjes së strukturave për objektin “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun Ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë”.

Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 16, datë 03.10.2018 “Për miratimin e lejes së Ndërtimit për Objektivin “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun Ujëmbledhës të Lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër dhe Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë” në pikën 3 të tij citon: “Dokumentin e Lejes së Ndërtimit i jepet subjektivit kërkues vetëm pas:

- a) Miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullor;
- b) Pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkive Mat dhe Mirditë.

Në vijim, AZHT-ja, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, me shkresën nr. 599/2 prot. “Lëshimi i Dokumentit të Lejes së Ndërtimit nr. 599/2 prot. datë 19.03.2019, miratuar me Vendimin nr. 16, datë 03.10.2018 të KKT-së”, i ka dërguar shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k, Dokumentin e Lejes së Ndërtimit Nr. 599/2 Prot. datë 19.03.2019. **Afati kohor i kësaj leje është 60 muaj.**

Subjektivit "Seka Hydropower" sh.p.k. është pajisur me Deklaratë Mjedisore në datën 19.07.2018, për projektin “Ndërtim i HEC-it Sekë dhe Zais” me vendndodhje mbi lumin Urakë dhe përroi i Melthit, Bashkia Mat dhe Mirditë, (i) në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, (ii) në përputhje të plotë me dispozitat e VKM-së nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, (iii) pasi është njohur me Raportin e Oponencës Teknike të AKBN-së mbi Projektin e Zbatimit të HEC-it “Sekë” të Shoqërisë Koncesionare “Hydro-Project” sh.p.k. (Seka Hydropower sh.p.k.) me nr. 2489 prot, datë 09.03.2016, (iv) konfirmimin nga ana e AKZM-së se sipërfaqja ku do të zhvillohet ky projekt ndodhet jashtë Zonave të Mbrojtura dhe nuk prek asnjë Monument Natyre, si dhe (v) pas kryerjes së procedurës së konsultimit me publikun.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se **subjektivit është pajisur me leje përdorimi të burimit ujor** (leja me nr.serie 00099 dhe nr.179 prot, datë 17.09.2018, të Këshillit të Basenit Ujor Mat) për funksionimin e HEC-eve me të dhënat si më poshtë:

HEC-it “Zajs” i është dhënë leja e përdorimit të burimit ujor me të dhënat:

- Koordinatat e VM-së: X - 428664; Y - 4621334; Z - 975 m.m.n.d.;
- Koordinatat e Godinës së Centralit (pikës së shkarkimit): X - 423732; Y - 4622309; Z - 711 m.m.n.d.;
- Prurja Mesatare: Qmes= 0.83 m³/sek;
- Prurja Llogaritëse: Qllog=1.2 m³/sek;
- Prurja Ekologjike: Qeko=0.15 m³/sek.

HEC-it “Sekë” i është dhënë leja e përdorimit të burimit ujor me të dhënat:

- Koordinatat e VM-së: X - 422969; Y - 4621626 ; Z - 698 m.n.d.;
- Koordinatat e Godinës së Centralit (pikës së shkarkimit): X - 420234; Y - 4617773; Z - 355 m.m.n.d.;
- Prurja Mesatare: Qmes= 3.3 m³/sek;
- Prurja Llogaritëse: Qllog=5.5 m³/sek;
- Prurja Ekologjike: Qeko=0.2 m³/sek

4 – KONSTATIMET NË PËRFUNDIM TË TAKIMEVE TË GNP-SË, VIZITËS NË TERREN, SI DHE VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Për sa i përket Parkut Kombëtar Lurë - Mali i Dejës dhe Kanioneve të Flimit e të Urakës

- **Gjurma e VM-së të propozuar për tu ndërtuar për HEC-in Zais, futet në territorin e Parkut Kombëtar të zgjeruar Lurë-Mali i Dejës.**

Bazuar në ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, kjo vepër nuk mund të ndërtohet në këtë territor, pasi VM-ja është futur në territorin e Parkut Kombëtar Lurë - Mali i Dejës afro 2450 m në brendësi dhe ndodhet në Zonën Qendrore të zonimit të territorit të këtij Parku Kombëtar.



- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se në momentin që METE ka lidhur kontratën e koncesionit të formës “BOT” me Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “Hydro Project” sh.p.k, dhe “Gener 2” sh.p.k

(Koncesionari), ashtu edhe në momentin që është miratuar ndryshimi i projektit të zbatimit për hidrocentralin “Sekë”, por edhe në momentin e lëshimit të Deklaratës Mjedisore nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, **sipërfaqja ku do të zhvillohet ky projekt ndodhej jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prekte asnjë Monument Natyre.**

Zgjerimi i sipërfaqes së Parkut Kombëtar Lurë dhe bashkimi me Parkun Kombëtar “Zall-Gjoçaj”, duke krijuar Parkun Kombëtar “Lurë–Mali i Dejës”, është miratuar me VKM nr. 661, datë 31.10.2018, “Për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar “Lurë” dhe krijimin e Parkut Kombëtar “Lurë–Mali i Dejës”.

- Sikurse cituar edhe më lart, gjatë kësaj vizite u konstatua se menaxhimi i mbetjeve inerte të gjeneruara si rezultat i punës për hapjen e traseve të rrugëve apo tunelit, ishte në përputhje me ruajtjen e ekuilibrit natyror të shpatit dhe shpateve në tërësi.

Pretendimi i banorëve se ndërtimi i këtij HEC-i dëmton Kanionet e Flimit dhe Urakës nuk qëndron. Bazuar kjo, si në inspektimin e datës 22.10.2019, ashtu edhe në inspektime të tjera të kryera nga stafi i rajonal i AKZM-së, të cilët kanë hyrë në brendësi të Kanionit të Flimit dhe **nuk kanë evidentuar gurë të rënë nga hapja e rrugës apo punimet që po kryhen në kuadër të HEC-it, por ato mund të jenë natyrshëm në kanion pasi shirat dhe koha e keqe ndihmon rënien e tyre.** Kanioni i Flimit nuk është pastruar ndonjëherë nga gurët e rënë as më përpara, por as tani. **Kanioni i Urakës nuk preket nga godina apo VM-ja e HEC-it Sekë.**

Për sa i përket aspektit hidrogeologjik

- Nga ekspertët e SHGJSH-së theksohet se ujërat nëntokësorë dhe ujërat sipërfaqësorë bashkëveprojnë (japin e marrin) me njëri – tjetrin. Duke qenë se, për këtë zonë nuk janë kryer studime të veçanta të këtij karakteri nga SHGJSH, saktësimi i shkallës së ndikimit të ujërave sipërfaqësorë me ato nëntokësorë dhe anasjelltas, si dhe përcaktimi i zonave të ushqimit të akuiferit është një detyrë e vështirë dhe kërkon studime të veçanta, të specializuara dhe bashkëpunim ndërinstytucional. **Akuiferi karbonatik i Dejës ka sipërfaqe të madhe, proceset karstike janë shumë të zhvilluara dhe ndërhyrjet në të mund të shkaktojnë impakte negative.**
- **Mbështetur në të dhënat që SHGJSH-ja disponon për zonën e studimit dhe nga verifikimi në terren nuk janë evidentuar burime ujore me prurje të konsiderueshme apo vepra për shfrytëzimin e ujërave nëntokësorë për furnizim me ujë të popullsisë.** Përcaktimi i shkallës së ndikimit të ujërave sipërfaqësorë në akuiferin karbonatik (në ujërat nëntokësorë) kërkon studime të mirëfillta dhe komplekse me gjurmues izotopik.
- **I vetmi burim i evidentuar që mund të ndikohet nga punimet për ndërtimin e HEC-it Zais është burimi “Kroi i Kolës” në fshatin Melth me prurje $Q = 0.3$ l/s (matur më 22.10.2019).**

Për sa i përket aspektit gjeologjik – inxhinierik

- Punimet e hapjes së trasesë së rrugës automobilistike që të çon tek vepra e marrjes së HEC-it Zais nuk kanë përfunduar ende. Punimet që do të kryhen për pjesën e mbetur, në bazë të pjerrësisë së shpateve ku do të kaloj traseja mund të shkaktojnë lindje të fenomeneve gjeodinamike si shembje gurësh apo rrëshqitje të karakterit lokal.

Bazamenti i trasesë së rrugës së hapur deri në afërsi të fshatit Melth është i qëndrueshëm, me veti gjeoteknike të mira.

Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve ligjore kontraktuale deri në momentin e vizitës në terren

- Në zbatim të nenit 8.1 të kontratës së koncesionit, *Koncesionari ka detyrimin të themelohet brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës, shoqërinë koncesionare, që do të nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri*. Koncesionari duhet të paraqesë aktin e themelimit, statutin dhe ekstraktin e regjistrimit të shoqërisë së re koncesionare, si dhe shkresën e miratimit nga Autoriteti Kontraktor. Ku nga kërkimi rezulton se:

Shoqëria e re “Seka Hydropower” sh.p.k është themeluar me datë 11.07.2013 dhe regjistruar me datë 16.09.2013 (referuar ekstraktit të shoqërisë në faqen zyrtare të QKB-së), por objekti i saj përmban vetëm ndërtimin e HEC-it Sekë.

- Në dokumentat që MIE dhe AKBN disponojnë mungon dokumentacioni që vërteton se **Koncesionari ka përmbushur detyrimin e tij në zbatim të nenit 30 të kontratës së koncesionit, i cili e detyron atë që të bëjë regjistrimin e Kontratës në regjistrin e pasurive të paluajtshme brenda 60 ditëve nga data e miratimit të projektit të zbatimit** (miratimi i projektit të zbatimit është lëshuar nga MEI (MIE) me nr.1881/3 prot., datë 26.04.2017).
- Në zbatim të nenit 10, pika 1, të kontratës së koncesionit, Koncesionari merr përsipër të filloj punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi do të bëhet 30 ditë nga data e miratimit të projekt zbatimit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues. Në rastin në fjalë, leja e ndërtimit mban datën 19.03.2019, ndërsa data e fillimit të punimeve sipas proces-verbalit të fillimit të punimeve është 25.03.2019. **Në këtë kuadër rezulton se Koncesionari ka filluar punimet sipas afatit të kontratës së koncesionit.**
- Në zbatim të nenit 10, pika 2 “Programi i Punimeve”, të kontratës së koncesionit, Koncesionari merr përsipër të vërë në punë HEC-in brenda 60 muajve nga data e fillimit të punimeve, **që është data 25.03.2024.**

Për sa i përket analizës së krahasueshmërisë teknike midis faktit dhe detyrimeve kontraktuale dhe lejeve që koncesionari disponon, konstatohet si më poshtë vijon:

Për HEC – in Sekë:

- **Vepra e marrjes**, në fazë ndërtimi e sipër, është pozicionuar më poshtë në kuotë krahasuar me kontratën shtesë të koncesionit dhe projekt zbatimin e miratuar. **Ky spostim është brenda kufirit të kuotës më të lartë.**
- **Sheshi i Godinës së Centralit**, u konstatua në fazë punimesh betonimi. Punimet kanë arritur deri në betonimin e bazamentit të themeleve. Kuota e matur është më poshtë se kuota e kontratës/projekt zbatimit të miratuar pasi ende nuk kanë arritur punimet në kuotën e bazamentit të godinës/aks turbinë.
- **Portalet e Tuneleve të Matura** nuk mund të krahasohen pasi kontrata e koncesionit – projekt zbatimi i miratuar – leja e ndërtimit e zbardhur nuk kanë referenca kuotash/koordinatash për këtë nënvepër (*pjesë e nënveprave brenda kufijve të hec/it/eve*).

Për HEC – in Zais:

- **Vepra e marrjes**, nuk kanë filluar ende punimet për këtë nënvepër – punohej për hapjen e trasesë drejt saj.
- **Sheshi i Godinës së Centralit**, (*ska filluar ende ndërtimi i godinës = kuota e godinës do të jetë edhe më lart*) pozicionohet më lart në kuotë se kontrata shtesë e koncesionit dhe projekt zbatimit të miratuar. **Ky spostim është brenda kufijve maksimal të kontratës. Ky spostim është brenda kufirit të kuotës më të ulët.**
- **Portalet e Tuneleve të Matura**, nuk mund të krahasohen pasi kontrata e koncesionit – projekt zbatimi i miratuar – leja e ndërtimit e zbardhur nuk kanë referenca kuotash/koordinatash për këtë nënvepër (*pjesë e nënveprave brenda kufijve të hec/it/eve*).

Referuar fazës së punimeve deri në këtë moment, nuk konstatohen shkelje/ndryshime të rëndësishme të projekt zbatimit të miratuar.

Për sa i përket konsultimit me publikun

- Procedura e konsultimit me publikun është realizuar konform legjislacionit në fuqi, duke respektuar afatet dhe të gjitha hallkat e procedurave në zbatim të VKM-së nr.247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, KREU II.
- **Njoftimi i parë publik është bërë në datën e aplikimit, 19.12.2017**, ku është publikuar në faqen e internetit të AKM-së, kërkesa për zhvillimin e degjesës me publikun. **Njoftimi i dytë është bërë në datën 05.01.2018**, me anë të posterave në zonat e ndikuara nga projekti, njësitë administrative Rukaj, Derjan dhe Selitë. **Njoftimi i tretë është bërë në mediat televizive lokale TV Mat dhe TV Lezhë për**

dy ditë rresht në datat 9 – 10 Janar 2018, transmetim spoti 2 herë në ditë. **Ndërsa, njoftimi i katërt është bërë në Gazetën Dita, në datat 10 dhe 11 Janar 2018.**

- Konsultimi me publikun është zhvilluar **me datë 11.01.2018, nga ora 11:00 deri në orën 13:00**, në ambientet e pallatit të kulturës të qytetit të Rrëshenit. Në këtë takim, kanë marrë pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor, përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Dibër dhe asaj Lezhë, si dhe përfaqësues nga studio mjedisore dhe subjekti.
- Gjatë këtij takimi është bërë prezantimi i projektit, si dhe janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve. Investitori, përveç se ka marrë përsipër që të përmbushë të gjitha sugjerimet e pjesëmarrësve, i ka siguruar ato se do të merren të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.
- **Kryetari i Njesisë Administrative Derjan, duke folur në emër të banorëve të njesisë administrative që ai përfaqëson, është shprehur kundër këtij projekti me argumentin se ai cënon në mënyrë indirekte banorët e kësaj njesisë administrative. Argument ky që është hedhur poshtë nga përfaqësuesi i subjektit.**
- Pjesa dërrmuese e pjesëmarrësve ka shprehur interesin për zhvillimin e projektit dhe punësimin e banorëve gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit, duke vlerësuar kontributin e tij në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, punësimin e njerëzve dhe zhvillimin e zonave ruale.

Për sa i përket lejes së përdorimit të burimit ujor

- Në lejen e përdorimit të burimit ujor janë vendosur kufizime në ushtrimin e veprimtarisë si **“Të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike”**.
- Duke qenë se subjekti vazhdon punën për zbatimin e projektit sipas fazave të parashikuara në grafikët e punimeve, aktualisht nuk jemi në kushtet e të shprehurit nëse përdorimi i burimit ujor bëhet sipas lejes së dhënë.
- Subjekti ka detyrim zbatimin e projektit për kuotat dhe koordinatat e veprave të marrjes dhe pikave të shkarkimit të ujit në **fazën e ndërtimit** dhe zbatimin e kushteve të lejes gjatë përdorimit të burimit ujor.

4 – REKOMANDIME

Në përfundim të shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit që institucionet përbërëse të kësaj GNP-je disponojnë, vizitës në terren, si dhe diskutimeve të zhvilluara ndërmjet anëtarëve të

kësaj GNP-je, Grupi Nderinstitucional i Punës ka dalë me rekomandimet e më poshtme:

Për sa i përket Parkut Kombëtar Lurë - Mali i Dejës

- Rinegociimi i projektit të zbatimit me Koncesionarin, brenda kushteve të kontratës së koncesionit të formës “BOT”, me qëllim që VM-ja e propozuar për tu ndërtuar për HEC-in Zais, të jetë jashtë kufijve të territorit të Parkut Kombëtar të zgjeruar Lurë-Mali i Dejës.

Për sa i përket aspektit hidrogjeologjik:

- Sikurse është cituar edhe në raportin hidrologjik dhe hidrogjeologjik për HEC-in Zais, shoqëria koncesionare gjatë hapjes së tunelit duhet të ruaj burimin “Kroi i Kolës” dhe të mos ndikojë në prurjen e këtij burimi.

Për sa i përket aspektit gjeologo – inxhinierik

- Sikurse është vepruar deri më tani, edhe për segmentet rrugore që do të ndërtohen duhet të vazhdohet të merren të gjitha masat për eliminimin e aktivizimit të fenomeneve gjeodinamike të rrezikshme.

Për sa i përket lejes së përdorimit të burimeve ujore:

- Ndërtimi i veprave të HEC-ve të bëhet në përputhje me të dhënat për koordinatat sipas lejes së miratuar. Çdo ndryshim duhet të bëhet me lejen e organeve të menaxhimit të burimeve ujore.

Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve ligjore kontraktuale deri në momentin e vizitës në terren

- Në ekstraktin e shoqërisë së re “Seka Hydropower” shpk, duhet rregulluar objekti i shoqërisë duke qenë se përmban vetëm ndërtimin e HEC-it Sekë, ndërkohë që kontrata shtesë e ka ndryshuar në Sekë dhe Zais;
- Koncesionari duhet të vërë në dispozicion të MIE-s dhe AKBN-së dokumentacionin që vërteton se Koncesionari ka bërë regjistrimin e Kontratës në regjistrin e pasurive të paluajtshme brenda 60 ditëve nga data e miratimit të projektit të zbatimit.